

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

24.01.2025
Ora, 13:54

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për një shtesë në vendimin nr. 10, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-------|-----------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | J. Josifi, A. Agolli. |

Parti Politike: PD (F. Nuri), PS (E. Xhina)

OJQ: S’ka prezent!

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, zyrtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfaqësues të partive politike. Në rendin e ditës të mbledhjes së sotme, kemi një projektvendim për të shqyrtuar, projektvendimin “Për një shtesë në vendimin nr. 10 datë 23.10.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”. Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit që kemi në rendin e ditës do të pyesja së pari, kolegët nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës më tej dhe përfaqësuesit e partive politike për të mbajtur rradhën e folësve dhe për të diskutuar çështjet në fund të rendit të ditës. Zoti Çakaj ka çështje?


Z. M. Çakaj: Po kemi çështje jashtë rendit të ditës. Për procedurë jashtë rendit të ditës kemi disa çështje.

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj keni dhe ju? Po! Përfaqësuesit e partive politike? Zoti Nuri? Po, ka çështje! Zonja Xhina? Po, ka çështje jashtë rendit të ditës.

Atëherë fillojmë me projektvendimin që kemi në rendin e ditës. Për të relatuar për këtë projektvendim, për këtë shtesë që propozohet, zonja Josifi do të lutesha, në mënyrë të përmbledhur të thoni çfarë përfaqëson kjo shtesë që është propozuar dhe cila ishte nevoja që e diktoi këtë ndryshim të propozuar.

Znj. J. Josifi: Po, faleminderit. Atëherë po kaloj menjëherë shkurtimisht te shtesa. Propozohet që në vendimin nr. 10, datë 23.10.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, të shtohet një pikë që lidhet me përgatitjen në fakt, të listës së zgjedhësve, me kreun e parafundit të këtij vendimi. Nevoja për këtë shtesë, të cilën po e artikuloj menjëherë më pas, ka ardhur për shkak të volumit të kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë vendit, që nga momenti që ky proces ka filluar. Në relacionin shpjegues të projektaktit në atë moment ishim 10 ditë nga dita e fillimit të procesit të regjistrimit dhe patëm më shumë se 50 mijë kërkesa nga të cilat, në atë moment, ishin miratuar rreth 29 mijë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Aktualisht, ky numër ka shkuar në 65765 kërkesa, nga të cilat të miratuara janë 41368 kërkesa. Pra, kishte një fluks të madh që në ditët e para të procesit të regjistrimit. Kështu për të lehtësuar punën e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, por edhe të vetë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në mënyrë që të ketë ndërkohë një punë përgatitore për të identifikuar këta zgjedhës, të cilët në përfundim të këtij procesi do të jenë pjesë e listës së zgjedhësve nga jashtë dhe do hiqen për pasojë nga lista e zgjedhësve brenda vendit për Zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj, ne mendojmë që lind nevoja për të parashikuar një pikë shtesë pas pikës 4 të Kreut V të vendimit tuaj nr.10. Në të kundërt, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile do ta merrte listën e shtetasve që KQZ u miraton kërkesën për regjistrim, vetëm përpara daljes së listës paraprake. Pra, 63 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Nëse ritmet e kërkesave për regjistrim dhe po ashtu të zgjedhësve të cilëve kjo kërkesë u miratohet do të vijojnë të jenë përgjatë gjithë periudhës së regjistrimit ashtu sikundër ishin në ditët e para dhe po vijojnë edhe sot që është data 24 janar, do të thotë që në ditët e fundit të daljes së listës paraprake do të kishim një volum shumë të madh të informacionit që KQZ do të duhet t'i dërgonte DPGJC. Ajo do të kishte shumë pak kohë në dispozicion dhe 2-3 ditë për të marrë masat e nevojshme dhe për të bërë rakordimin në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe asaj brenda vendit. Nga ana tjetër, kjo shtesë që propozohet do të mundësonte që edhe auditët teknikienë të emëruar sipas nenit 61 të Kodit Zgjedhor, të mund të verifikojë në kohë dhe me cilësi procesin e hartimit të listës së zgjedhësve nga jashtë vendit dhe reflektimin e këtyre ndryshimeve në listën e zgjedhësve brenda vendit. Kemi propozuar që gjatë procesit të administrimit të kërkesave për regjistrim, KQZ ta vërë në dispozicion të DPGJC listën e shtetasve të cilëve u është miratuar kërkesa, çdo ditë të hënë. Pra, një herë në javë në mënyrë që të kenë mundësinë që brenda 24 orëve të mund të hartojnë dhe të publikojnë ekstraktin e listës së zgjedhësve nga jashtë vendit sipas

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*


përbërësve të listës së zgjedhësve tashmë të përcaktuar në vendimin tuaj nr. 10. Përsa më lart, në këtë relacion, Komsioneri Shtetëror i Zgjedhjeve brenda kompetencave të veta, si dhe në respektim të detyrimeve dhe afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor propozon, për shqyrtim dhe miratim, Komisionit Rregullator, projektvendimin “Për një shtesë në Vendimin nr. 10, datë 23 tetor 2024 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”. Faleminderit

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Josifi. Fillojmë atëherë me diskutimin në parim të projektvendimit. Në këtë fazë të shqyrtimit, të diskutimit në parim, së pari e kanë fjalën përfaqësuesit e partive politike dhe më tej anëtarët e Komisionit Rregullator. Zonja Xhina, zoti Nuri, në parim, me këtë projektvendim, keni diçka? Dakord! Faleminderit! Kolegë, zoti Çakaj

Z. M. Çakaj: Po, faleminderit zonja Kryetare. Unë e dëgjova me vëmendje relatimin e drejtoreshës së votimit nga jashtë. Parimisht biem dakord me nevojën për ndërhyrje në këtë akt. Por paraprakisht, duke qenë se po ndërhyjmë në vendimin nr. 10 i cili është vendimi që normon procesin e regjistrimit të zgjedhësve nga jashtë. Përpos këtij ndryshimi që ju propozoni, duke qenë se jemi në vijim të procesit të regjistrimit nga jashtë, nisur nga gjithë problematikat të cilat do t'i diskutojmë më gjerësisht pasi të shqyrtojmë dhe potencialisht të miratojmë këtë propozim. Mendoni se ka nevojë për ndryshime të tjera në vendimin nr. 10, të cilat do të ndihmojnë procesin e regjistrimit të emigrantëve?

Znj. I. Nano: Zonja Josifi?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Znj. J. Josifi: Nuk ka një propozim për ndryshime të tjera nga ana e komisionerit, nuk është në vullnetin e tij përpos ndryshimit që propozohet sot pranë jush.

Znj. H. Vukaj: Pra, ideja është që në meritë të implementimit të të gjithë parimeve dhe të bërit të qenësishëm, të thjeshtë, të lehtë, gjithpërfshirës të këtij procesi, cilat janë arësyet e kësaj diference kaq të madhe? Këto arsye ju nuk i keni materializuar, ndoshta në nevojë, nga e cila do të lindnin më pas edhe propozime të tjera, sot, dje, nesër edhe gjithmonë, sa herë të keni nevojë në shërbim të implementimit sa më mirë të procesit?

Znj. J. Josifi: Jemi përpjekur të adresojmë numrin e refuzimeve dhe arësyet që lidhen, siç e dimë tashmë të gjithë, me dokumentin provues të adresës nga ana e shtetasve që sjellin kërkesën për regjistrim, duke shtuar edukimin dhe informimin për zgjedhësit, në të gjitha mënyrat për ta përcjellë këtë mesazh publikisht dhe madje disa herë në ditë. Pra, jemi duke i trajtuar problematikat konkrete sipas shteteve të caktuara dhe shtetasve përmes një komunikimi publik intensiv. Kështu, që siç e thashë, nuk ka qenë dhe nuk është në vullnetin e Komisionerit, të paktën deri sot, propozime të reja që lidhen me vendimin nr. 10 apo edhe me vendimin nr. 11, meqë lidhet edhe ai me regjistrimin.

Znj. I. Nano: Dakord! Diskutime të tjera në parim. Personalisht po e shpreh pëlqimin tim paraprakisht për këtë propozim që na ka ardhur. Parimisht do të shprehem dakord dhe me votë dhe gjithashtu, po personalisht shpreh gatishmërinë që sa herë që të ketë nevojë që të mundësojmë ndryshime në funksion të një procesi, sikundër edhe kolegët e theksuan, të drejtë, transparent, të shpejtë. Besoj të pestë e kemi shprehur vullnetin që të mblidhemi sa herë që të lindë nevoja për të përmirësuar

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

procese për të cilat jemi shprehur tashmë, por në varësi të situatave që mund të vijnë dhe për atë sa na lejon koha, të mund të përmirësojmë aktet në mënyrë që të mund të përmirësohen proceset. Nuk kemi diskutime të tjera në parim, kështu që kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në tekstin e projektvendimit. Me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

1. Në tekstin e vendimit nr. 10, datë 23.10.2024, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve” bëhen shtesat si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 4 të Kreut V shtohet pika me përmbajtjen si vijon:

“Gjatë procesit të administrimit të kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë vendit, KQZ I vë në dispozicion DPGJC, cdo ditë të hënë, listën e shtetasve të cilëve u është miratuar kërkesa për regjistrim. Kjo listë gjenerohet në mënyrë automatike nga platforma elektronike e regjistrimit PER dhe i vendoset në dispozicion DPGJC në format elektronik. DPGJC merr masa të hartojë dhe publikojë ekstraktin e listës së zgjedhësve nga jashtë vendit, të cilëve u është miratuar kërkesa për regjistrim, brenda 24 orëve, sipas përbërësve të listës së zgjedhësve nga jashtë vendit, të përcaktuara në këtë vendim”.

Atëherë për pikën 1, më së pari kolegët, pastaj përfaqësuesit e partive politike nëse kanë ndonjë sugjerim.

Zgj. I. Nano: Zonja Vukaj!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*


Znj. H. Vukaj: Ndërsa zonja Nano lexonte tekstin, mua më lindi një pyetje rastësisht të cilën kam nevojë ta dëgjoj nga administrata. Nëse bëhet dhe është implementuar, apo aplikohet siç e kemi miratuar ne në vendimin nr. 10. Në tekst është propozuar që ekstrakti të jetë miratuar më përpara se t'i dërgohet DPGJC. Unë kam pyetjen, kjo listë e emrave të pranuar si zgjedhës tashmë, miratohet me një vendim të komisionerit apo thjesht gjenerohet nga PER?

Znj. J. Josifi: Jo, thjesht gjenerohet nga PER duke qenë që kodi ndërkohë ka përcaktuar që e vetmja listë që Komisioneri do të duhet të miratojë me vendim është lista përfundimtare. Lista paraprake thjesht publikohet nga ana e Komisionerit kështu që automatikisht sistemi do të nxjerrë listën e shtetasve të cilëve u është miratuar kërkesa. Ndërkohë në përgjigjen që i shkon shtetasve për shqyrtimin e kërkesës, në rastin e miratimit ata kanë njoftim, ashtu sikundër në rastin e refuzimit ka një vendim të Komisionerit "Për miratimin", njoftimi që i shkon zgjedhësit në PER, është në emër të Komisionerit. Pra, nuk miratohet me ndonjë akt më, ky ekstrakt. Kjo edhe për faktin se ekstrakti nxirret nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe jo nga KQZ. KQZ i jep kësaj të fundit listën e shtetasve të miratuar.

Znj. H. Vukaj: Ndoshta unë gabova në fjalën e duhur. Pra, listën dhe jo ekstraktin, se ekstrakti vjen më pas. Por, doja të sigurohesha nëse ka vendim për këtë?

Znj. J. Josifi: Jo, sepse ndërkohë kërkesat janë shqyrtuar dhe nuk kanë nevojë për një akt tjetër. Komisioneri e ka deleguar, po themi kështu, ose vepron përmes platformës në këtë proces.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Z. M. Çakaj: Kisha edhe unë një pyetje.

Znj. I. Nano: Po, zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Lista e cila i vendoset në dispozicion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe publikohet nga DPGJC. Ku publikohet? Në faqen elektronike të DPGJC?


Znj. J. Josifi: Njëlloj si dhe ekstraktet e listës brenda vendit.

Z. M. Çakaj: Cilët janë elementët e listës që publikohen? Emër, atësi, mbiemër? Po datëlindja publikohet?

Znj. J. Josifi: Publikohen sipas parashikimeve në vendimin tuaj numër 10. Përbërësit e listës së zgjedhësve janë ato të Kreut V, pika 8 dhe thotë “Lista e zgjedhësve nga jashtë vendit përmban emërtimin e zonës zgjedhore, llojin dhe datën e zgjedhjeve dhe përbërësit zgjedhorë të zgjedhësve sipas përcaktimeve të pikës 4 të këtij kreu”. Shkojmë te pika 4, e Kreut V të vendimit 10, “Përbërësit e listës së zgjedhësve jashtë vendit përfshin përbërësit zgjedhorë të përcaktuar në shkronjën “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “f” të pikës 1, të nenit 45 si dhe..”. Pra, ndryshe nga lista brenda vendit, “... shtetin adresën e të cilit ka deklaruar zgjedhësi që voton nga jashtë vendit”.

Z. M. Çakaj: Të njëjtët përbërës zgjedhorë, me përjashtim të pikës “ë”, që është kodi i vendbanimit, në mos gaboj, të njëjtët përbërës zgjedhorë që ndjek publikimi i listës nga brenda vendit, do të veprojnë edhe për listën nga jashtë vendit?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Znj. J. Josifi: Po, plus shtetin.

Z. M. Çakaj: Po, po duke shtuar edhe shtetin e origjinës nga është regjistruar.


Znj. H. Vukaj: Edhe një shtesë të vogël, të lutem, për saktësi dhe transparencë. Lista përmban të gjithë emrat e atyre që i është konfirmuar apo pranuar regjistrimi? Me ID të skaduar, me ID të paskaduar? Pra, me dokument identifikimi të vlefshëm apo të pavlefshëm? Apo janë selektuar vetëm ata me dokument të vlefshëm?

Znj. J. Josifi: Ne do të dërgojmë të gjithë listën e shtetasve të cilëve u është miratuar kërkesa për regjistrim. Kërkesa për regjistrim ju është miratuar edhe shtetasve me dokument... Vendimi juaj nr. 10 është i qartë në këtë pikë. Ne çojmë të gjitha kërkesat e miratuara me dokument apo pa dokument të vlefshëm.

Znj. I. Nano: Atëherë për pikën 1 nga kolegët ka propozime për shtesa, ndryshime? Nga përfaqësuesit? Po, zonja Xhina?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Në vijim të diskutimit që u bë edhe nga ana juaj, unë kam një propozim. Në fund të pikës 1 ku përfundon formulimi i sjellë nga Komisioneri, të bëhet një shtesë me këtë përmbajtje, “Një kopje e ekstraktit të listës së zgjedhësve nga jashtë vendit, hartuar nga DPGJC, i vihet në dispozicion KQZ, e cila e publikon atë në faqen zyrtare të internetit”. Është në kuadër të transparencës dhe informimit, pavarësisht faktit që na u tha që do të publikohet, por e thënë në këtë akt është një garanci për transparencë dhe informim. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Znj. I. Nano: Po, zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Në kuadër të transparencës, unë kam një pyetje për administratën. Marr shkas nga ky propozim i zonjës Xhina dhe kam një pyetje. Në Kodin Zgjedhor parashikohet që publikimi i ekstraktit, i listës paraprake dhe listës përfundimtare i është ngarkuar DPGJC. Ka ndonjë përplasje kompetencash, nëse këtë listë e publikon edhe KQZ në faqen e saj? Shihni ndonjë pengesë ligjore? Nëse nuk shihni, në kuadër të transparencës, dakord.

Znj. I. Nano: Unë personalisht e shoh në kuadër të lehtësisë, por edhe të faktit që në dallim nga brenda vendit, listën përfundimtare jashtë vendit e miraton Komisioneri. Pra, është KQZ shumë aktive në këtë proces. Kështu që duke e bërë në mënyrë periodike, pra do të prodhohet një ekstrakt.


Z. M. Çakaj: Dakord, dakord, e miraton KQZ, por përsëri ia kalon DPGJC.

Znj. I. Nano: Duke qenë që të gjitha të dhënat për shtetasit gjenden aktualisht në faqen e KQZ,, për votues nga jashtë të dhënat janë të prezantuara këtu dhe që gjithsecili e konsulton. Le të jetë dhe kjo njëherë në javë.

Z. M. Çakaj: Unë jam dakord në parim. Nëse administrata vlerëson se nuk ka ndonjë pengesë, ose ndonjë mbivendosje kompetencash ndërmjet DPGJC dhe KQZ, dakord jemi në parim.

Znj. I. Nano: Po, zoti Çaka?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Z. D. Çaka: Mendoj se kjo do të jetë një lehtësi më shumë për qytetarët, pasi të jemi realistë, kushdo që sheh në këto momente, ose vëren si procedurën, po ashtu edhe mënyrën sesi do të procesohet. Pra, është faqja e KQZ ajo që shihet nga zgjedhësit nga jashtë. Të jemi realistë. Nuk është se shumë zgjedhës nga jashtë shohin faqen e DPGJC. Patjetër nëse nuk ka edhe pengesa.

Z. M. Çakaj: Në pamje të parë kjo i shërben, po përdor një term të moderuar, kordinatorëve të partive politike, që diku e kanë emrin patronazhistë, diku vullnetarë, diku e kanë aktivistë. Megjithatë përsa kohë është në kuadër të transparencës...

Z. D. Çaka: Kodi Zgjedhor e mundëson këtë edhe për ta kërkuar partitë politike, madje edhe në version elektronik me kërkesë të partive politike.

Z. M. Çakaj: Me kërkesë të patronazhistëve.

Z. D. Çaka: Po u publikua te faqja e DPGJC, njëlloj është pastaj, në çdo faqe interneti.

Znj. I. Nano: Dakord! Kemi propozimin e zonjës Xhina. Kam edhe unë një propozim, thjesht për ndryshimin e një fjale në tekst. Që në fjalinë e parë pra, “KQZ ju vë në dispozicion DPGJC...”. Unë them “i përcjell”, më tepër sesa të jenë në dispozicion institucionet. Edhe në fjalinë e dytë, “...i vendoset DPGJC në format elektronik...”, të thuhet “i përcillet”. Teknikisht, DPGJC ia çojmë ne, nuk është se ndërvepron ajo me platformën. Pra, te dy pikat “i vë në dispozicion”, unë kam propozimin “i përcjell”. Kemi dy propozime. Propozimi i zonjës Xhina. Zonja Xhina, i mbeteni propozimit tuaj?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Kalojmë në votimin e propozimit për të shtuar një fjali në fund të pikës që është propozuar për t'u shtuar.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kemi dhe propozimin tim për të zëvendësuar fjalën “i vë në dispozicion”, në dy fjali me “i përcjell”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 2. Ngarkohet administrata e KQZ dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim për zbatimin e tij. Kush është dakord?

Z. M. Çakaj: Kisha diçka. Atë formulimin që kemi miratuar së bashku dhe e kemi bërë si standard. Ngarkohet KQZ dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim për zbatimin e tij.

Znj. I. Nano: Pra, “Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim, për zbatimin e tij”.


Kush është dakord me propozimin e zotit Çakaj?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të KQZ.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në miratimin në tërësi të projektvendimit. Dhe njëherë kolegë.

Kush është dakord?

Z. M. Çakaj: Më fal, kisha dhe diçka. E kemi bërë prezent këtë shqetësim shumë herë. Është e disata herë që ne na paraqitet relacioni për propozimin e këtij projektvendimi i pa firmosur. Propozuesit janë: zonja Josifi, Pavlina Doçaj dhe zonja Çelmeta. Së pari, është i pafirmosur. Mbase në formatin elektronik e kemi të firmosur por meqë po shqyrtojmë këtu është e disata herë kështu që ju tërheqim vëmendjen. Do të ishte mirë që të paktën atë çfarë parashikon edhe rregullorja jonë, atë çfarë parashikon edhe rregullorja e KQZ të zbatohen.

Znj. H. Vukaj: Ju e dini që jeni draftues dhe jo propozues.

Znj. I. Nano: Dakord! Kalojmë në miratimin në tërësi të projektvendimit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Kolegë, kush është dakord?


Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Vendimi nr. 3

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

24.01.2025
Ora, 14:18

JASHTË RENDIT TË DITËS

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- **Ilijana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ J. Josifi, A. Agolli.**

Parti Politike: PD (F. Nuri), PS (E. Xhina)

OJQ: S'ka prezent!

Znj. I. Nano: Vazhdojmë me çështjet jashtë rendit të ditës kemi radhën e folësve: zoti Çakaj, zonja Vukaj, zoti Nuri, zonja Xhina.

Z. M. Çakaj: Faleminderit zonja kryetare. Jo pa qëllim në diskutimin në parim të këtij projektakti që paraqeste propozim për ndryshime në vendimin nr. 10 e pyeta zonjën Josifi lidhur me propozime për ndryshime të mundshme në vendimin nr. 10, të cilat do t'i shërbenin procesit. Pra, në kuadër të zbatimit të parimit të gjithpërfshirjes, të thjeshtësisë dhe sigurisht në kuadër të parimit të ligjshmërisë të regjistrimit të zgjedhësve nga jashtë. Çfarë konstatoj nga gjithë ky proces, të paktën

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

nga dyjavëshi i parë. Kemi të dhënat në kohë reale të regjistrimit të votuesve nga jashtë nga ku figuron që gjithsej totali i kërkesave 65.000 në këtë moment 65.765 nga të cilat të miratuara Atëherë numri total i kërkesave për regjistrim në KQZ është 65.969. Të miratuara rezultojnë 41.479. Të refuzuar rezultojnë 24.480 shtetas shqiptarë të cilët kanë paraqitur kërkesë, ose 37% e të gjithë aplikantëve janë refuzuar. Pra, më shumë se 1/3. Unë personalisht e gjej shumë shqetësuese këtë. Paraprakisht, përpara se të zhvillonim këtë mbledhje unë dhe kolegja zonja Vukaj ju kemi kërkuar informacion të detajuar lidhur me problematikat në trajtimin e kërkesave për regjistrim dhe kryesisht pse është ky numër kaq i madh refuzimesh? Kam edhe pyetje të tjera, por do të doja një përgjigje shteruese për këtë, me sa mund të jetë shteruese.

Znj. J. Josifi: E kemi përcjellë informacionin e kërkuar me email. Kemi marrë rastet tipike të arsyeve të refuzimit, ose ato të cilat i kemi hasur në masë në shtetet nga të cilat kemi më shumë kërkesa për regjistrim. Arsyeja kryesore është që dokumenti provues i adresës nuk është ai që plotëson kushtet e vendimit nr. 10. Nëse dëshironi që unë të lexoj materialin e përcjellë me rastin e Italisë, që ka pasur në fakt me kalimin e ditëve përmirësim. Kemi vënë re që në riaplikime është adresuar çështja e dokumentit të përdorur, fotografimi nga ana e pasme ku gjendet adresa dhe jo nga ana e përparme e ID. Vijon të ngarkohet patenta në këtë rast e cila nuk e përmban fare adresën...

Z. M. Çakaj: Qartë, qartë... Problematika kryesore, në vijim edhe të përgjigjes së sjellë nga ana juaj, është mungesa e dokumentacionit të duhur i cili provon qëndrimin jashtë. Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj në vendimin nr. 10, të miratuar nga ky komision në Kreun 4, pika 8, ne kemi miratuar parashikimin, "Në rast të

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

vështirësive për të realizuar regjistrimin sipas hapave të mësipërm, zgjedhësi mund të ruajë draftkërkesën në PER dhe të kontaktojë për ndihmë teknike për procesin e regjistrimit. Shërbimin e ndihmës që KQZ vendos në dispozicion të zgjedhësve nga jashtë vendit përgjatë gjithë periudhës së regjistrimit”. Në dijeni tonë, të të pestë anëtarëve këtu, ashtu siç e kemi konceptuar ne, së bashku me ju, miratimin e këtij paragrafi, në materializimin në PER do të thotë që, KQZ ndërvepron me zgjedhësi. Nuk ka rëndësi ndërvepron procesin e regjistrimit, apo paşi ai nuk e ka aplikuar me sukses. Komunikimi i KQZ do të duhet të jetë para, gjatë dhe pas procesit në mënyrë që një zgjedhës të realizojë me sukses aplikimin. Në vlerësimin dhe gjykimin tim objektiv, fakti që kemi më shumë se 1/3 e kërkesave të refuzuara, mendoj që ky parashikim, të gjithë e kemi parasysh, ju e keni përditshmëri punë 24 në 7 këtë proces. Ky proces është i pamundur, nuk realizohet. Pra, ndërveprimi në kohë reale nuk realizohet. Por, edhe më pas nuk e di se sa përqind keni mundur ju ta realizoni? Pra, ndërveprimin me zgjedhësit ku nga ana e operatorit të KQZ të merret, komunikohet t’i njoftohet, “I nderuar zgjedhës nga jashtë, aplikimi juaj u refuzua ose nuk u mundësua me sukses”. Pra, mos ta dekurajojmë. Për këtë arsye, për arsye të skanimit gabim të dokumentit të identifikimit dhe ju lutem nëse aplikanti nga Italia ka një dokument, karta e identitetit e ka në faqen e pasme adresën, atëherë të orientohet ekzaktësisht. Unë deri më sot konstatoj ose është bërë pak, ose nuk është bërë fare nga ana e KQZ. Në këtë kontekst ua shtrova pyetjen, ka nevojë për ndryshime amendime ligjore për ta thjeshtëzuar procesin? Së pari, kjo! Do të më lejoni dhe 2 shqetësime të vogla. Së dyti, kemi një numër 2452 zgjedhës shqiptarë të cilët janë regjistruar por kanë nevojë në mënyrë që të jenë efektive në votim, kanë nevojë për rinovim të dokumentit, të pajisjet me një dokument të vlefshëm identifikimi, pasaportë apo kartë identiteti. Ka ndërmarrë KQZ, komisioneri në rastin konkret i ngarkuar nga Kodi Zgjedhor, ndonjë nismë, ndonjë komunikim me

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

ministrinë tonë të jashtme nga varen kosullatat, apo ambasadat shqiptare kudo në botë? Në lidhje me thjeshtëzimin e procesit apo ta bëjë të mundur të drejtën e tyre për të votuar nga jashtë?

Znj. J. Josifi: Ashtu sikundër e ka deklaruar publikisht edhe Komisioneri, ka qenë në rakordim edhe me Ministrinë e Brendshme. Në fakt, janë marrë të dhënat aktuale mbi statistikën e shtetasve shqiptarë, të cilët e kanë dokumentin e skaduar, ju skadon në vazhdim apo edhe nuk kanë fare një dokument identifikimi të lëshuar nga shteti shqiptar. Po, ka qenë në komunikim të vazhdueshëm edhe me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe mbetet detyrë e këtyre dy institucioneve që ta realizojnë këtë gjë.

Z. M. Çakaj: Ka ndonjë shkresë, dokument apo email që ka ndërmarrë veprime aktive për këtë çështje që ju sapo deklaruat?

Znj. J. Josifi: Ka zhvilluar takime dhe janë të publikuara. Sa i takon pyetjes suaj të parë, ne kemi linjat e ndihmës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të cilat janë të publikuara në PER. Kemi disa forma dhe në fakt gjatë këtyre ditëve, zgjedhësit i kanë përdorur të gjitha. Ata kanë mundësinë që të na shkruajnë në WhatsApp dhe të kontaktojnë me një person nga ana tjetër e ...

Z. M. Çakaj: Për kureshtje, sa operatorë të ndihmës së KQZ-së janë të punësuar aktualisht? Unë e di numrin, por për kureshtje të publikut.

Znj. J. Josifi: Nëse nuk gaboj, janë 16 operatorë të ndihmës, por më lejoni pak që ta kem të saktë këtë shifër...

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Z. M. Çakaj: Sa janë funksionalë, pasi dje në orën pesë kanë qenë vetëm dy?

Znj. J. Josifi: Atëherë, e keni fjalën për persona, të cilët shqyrtojnë kërkesa për regjistrim apo ata që ndihmojnë zgjedhësit?

Z. M. Çakaj: Ata, të cilët ndihmojnë zgjedhësit.

Znj. J. Josifi: Ata që ndihmojnë zgjedhësit janë 16 persona. Ata nuk qëndrojnë në sallën e shqyrtimit të kërkesave ku keni qenë ju dje. Ata janë operatorë, të cilët i shërbejnë Help Desk-ut teknik. Ata që janë Help Line për zgjedhësit punojnë 24 orë.

Z. M. Çakaj: Aktualisht, sa janë në turn operatorë që shërbejnë në Help Line në ndihmë të zgjedhësve?

Znj. J. Josifi: Aktualisht, në ndihmë të zgjedhësve janë pesë operatorë. Ndërsa në shqyrtimin e kërkesave kemi më shumë operatorë. Po ta them ekzaktësisht sipas kalendarit të punës. Sot ka përfunduar kalendari i 10-ditëshit të parë dhe nga nesër e deri të shtunën që vjen, vijon kalendari i radhës. Aktualisht, në shqyrtimin e kërkesave në turnin e parë janë 13 punonjës, në turnin e dytë janë 12, në turnin e tretë janë 10 dhe po 10 në turnin e katërt.

Z. M. Çakaj: Atëherë, ta bëjmë ndryshe. Sa operatorë të KQZ-së gjatë një turni marrin kërkesa nga zgjedhës nga jashtë Shqipërisë, të cilët kanë hasur problematika?

Znj. J. Josifi: Të gjithë ata që kanë kërkuar kontakt me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Z. M. Çakaj: Po pra, po sa janë? Sa ndihmues jemi ne në një turn, pasi te ajo zyrë që përmendni ju, ditën e djeshme kam konstatuar vetëm dy operatorë.

Znj. J. Josifi: Edhe një herë. Ata janë operatorët e Help Desk-ut teknik, jo për zgjedhësit. Ata u shërbejnë operatorëve tanë të shqyrtimit të kërkesave dhe sitemit. Ata që keni parë dje nuk janë Help Line për zgjedhësit.

Z. M. Çakaj: Ata që komunikojnë me WhatsApp, 16 janë?

Znj. J. Josifi: Po.

Z. M. Çakaj: Po si ka mundësi që nuk bie ai numri aty? Ka qenë 23% numri i të refuzuarve dhe ka shkuar 37.1%. Tani çalon diku puna, ose tek edukimi zgjedhor, ose te informimi i duhur i zgjedhësve, ose ne nuk jemi në gjendje t'u japim atyre zgjidhje. Nuk ka mundësi që ta kenë fajin vetëm emigrantët, emigrantët, emigrantët. Ju thoni që në 100 mijë kërkesa, 37 mijë nuk regjistrohen. Pse duhet dikush që të shprehë vullnetin e tij për të votuar nga jashtë Shqipërisë, kur nuk e paska këtë vullnet? Në këtë proces, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, zoti Ilirjan Celibashi në grupin e dialogut ka deklaruar, "Po, KQZ e realizon këtë". Në fakt, nuk ka deklaruar që e realizon për 2/3-at, por për 100%. Por, po rezulton që KQZ po e bën për më pak se 2/3-at, pasi më shumë se 1/3-a është e paregjistruar dhe po has vështirësi. Në këtë kontekst, çfarë masash duhet të marrim ne të gjithë bashkë, dhe në rastin konkret si rregullatorë, që ta ndihmojmë procesin?

Znj. J. Josifi: Ky mbetet mendimi im personal në këtë rast dhe nuk lidhet me projektvendimin. Mendoj se komunikimi publik intensiv do të ishte një ndihmesë.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Znj. I. Nano: Po, e ka fjalën zoti Çaka!

Znj. H. Vukaj: Më fal që ndërhyra kolegu Çaka. Ju mund të jepni vetëm mendimin tuaj individual, pasi këtu duhej të ishte Komisioneri dhe të shprehte se si është situata nën përgjegjësinë e tij. Çfarë ka marrë ai përsipër të realizojë dhe sa e ka implementuar të gjithë paketën e akteve tona? Si është raporti dhe si janë pritshmëritë e zgjedhësve për këtë të drejtë kushtetuese që i është besuar KQZ-së në të gjitha mënyrat?

Z. D. Çaka: Kam një pyetje në raport me sistemin dhe me informacionin. Shohim që kemi 65.969 kërkesa dhe 24.480 refuzime. Nëse 1, 2, apo 200 nga këto 24.480 refuzime, riaplikojnë duke riplotësuar edhe një herë dokumentacionin, kjo 200, 2000 apo 5000, i shtohet numrit 65.000 të kërkesave, apo këta persona duke qenë se kanë aplikuar një herë, nuk shtohen tek ky numër? Në këtë rast, kërkesat e refuzuara mbeten po 24.000, apo do hiqet kjo diferencë e atyre që kanë riplotësuar dokumentacionin? Nëse do të shtohet, atëherë do të kemi një ngatërresë dhe mund të mos jetë numri real, në vlerësimin tim.

Znj. J. Josifi: Atëherë, tab-it së cilës ju i referoheni që është rreshti i parë i të dhënave statistikore, lidhet me numrin e kërkesave dhe jo me numrin unik të zgjedhësve. Në atë numër kërkesash 65.969, kemi zgjedhës të përsëritur që kanë riaplikuar. Po flas vetëm për këtë tab, pasi më poshtë janë të dhënat unike. Në tre shifrat e para, unikë janë ata 41.479. Pra, janë shtetas unikë të miratuar. Numri i zgjedhësve të miratuar dhe të refuzuar janë më poshtë. Ju lutem, mos ju referoni vetëm kërkesave. Kërkesat janë kërkesa, nuk janë zgjedhës.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Z. D. Çaka: Prandaj ishte pyetja ime. Refuzimi i 24.000 kërkesave dhe miratimi i 38.000 kërkesave, nuk do të thotë...

Znj. J. Josifi: Atëherë, 41.479 që janë zgjedhës, janë shuma e zgjedhësve që kanë pasur dokumentin e vlefshëm në momentin e kërkesës dhe ata që nuk e kanë të vlefshëm dokumentin në atë moment, por që pritet ta ringarkojnë dokumentin.

Z. D. Çaka: Pyetja ime është e tillë. Përveçse numrit të shtetasve që ju është miratuar kërkesa, çdo gjë tjetër nuk ka të bëjë me numrin e individëve që kanë aplikuar. Pra, ne nuk kemi 65.000 individë që kanë aplikuar?

Znj. J. Josifi: Jo, kemi më pak.

Z. D. Çaka: Dhe nuk kemi 24.000 shtetas të refuzuar?

Znj. J. Josifi: Jo!

Z. D. Çaka: Pra, janë kërkesa dhe te numri 24.000, mund të jetë edhe një qytetar që i është refuzuar kërkesa dhjetë herë?

Znj. J. Josifi: Po, mund të jetë.

Znj. I. Nano: Nisur nga kjo që zoti Çaka theksoi, ajo që është e barabartë midis numrit në tabelë me shtetasit, janë vetëm ata të miratuar me vendim, 41.479 zgjedhës.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Znj. J. Josifi: Nëse duam numrin e shtetasve të refuzuar, mjafton të mbledhim këto 12 shifra...

Znj. I. Nano: Pra, me atë numër të krijohet ideja se ka qytetarë, që u është refuzuar kërkesa në atë numër, me shumicë.

Z. M. Çakaj: Në vijim të kërkesës, numri mund të mos ishte 24 mijë, por 20 mijë.

Znj. H. Vukaj: A mund t'i thoni dikujt që të nxjerrë tani numrin e shtetasve unikë të refuzuar dhe jo të kërkesave, sepse edhe refuzimi i kërkesave ju rëndon. Kjo do të thotë se një kërkesë mund të jetë përsëritur dhjetë herë. Numri i shtetasve unikë që u është refuzuar kërkesa duhet të jetë aty si informacion.

Z. M. Çakaj: A e keni numrin e telefonatave apo mesazheve që KQZ i bën për të ndihmuar zgjedhësit? E keni kollaj ta nxirrni?

Znj. J. Josifi: Nuk e kam për momentin këtu dhe më duhet që ta nxjerr, pasi është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës. Ne i përgjigjemi cilitdo zgjedhësi që na kontakton...

Z. M. Çakaj: Po them tjetër gjë. Numrin e telefonatave që ne vetë, pasi shohim që një zgjedhës ka aplikuar dy, tre apo katër herë, në këtë rast besoj referuar pikës 8, Kreu IV të vendimit 10, duhet që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në ndërveprim me zgjedhësin, të komunikojë. Pasi duket qartë që ai zgjedhës po has vështirësi në regjistrim. Në rastin konkret, sa telefonata, apo mesazhe bëjmë ne për ta zgjidhur këtë problem? Mund ta kemi?

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Znj. J. Josifi: Koncepti i ndihmës është që ne jemi në dispozicion, që sa herë na kërkohet ndihmë, në çdo orë dhe çdo lloj ndihme që na kërkohet. Ne u jemi përgjigjur të gjitha kërkesave për ndihmë që na janë bërë me email, WhatsApp, tekst, telefon, me zë apo Chatbox. Kemi statistika për të katërta këto mënyra komunikimi, ose ndihme dhe jua vendosim menjëherë në dispozicion, i nxjerrim nga sistemi.

Z. M. Çakaj: Nëse një zgjedhës nga jashtë është përsëritës në pamundësinë e regjistrimit, pasi edhe sistemi është disi i ngatërruar dhe në idenë tonë kjo platformë duhej të ishte më e thjeshtë. Ndërveprimi nuk nënkupton që të përgjigjemi vetëm kur vijnë telefonata, por duhen edhe veprime proaktive të vetë KQZ-së. Në momentin kur sheh që një zgjedhës nuk ka arritur të regjistrohet pas 3-4 herësh që ka tentuar, atëherë mund të kontaktohet nga KQZ. Unë nuk shoh asnjë pengesë ligjore, përpos që është detyrim nga parashikimi që sapo citova. Në vijim mund të kemi një numër se sa telefonata bëjmë apo sa mesazhe dërgojmë ne për të orientuar zgjedhësit që të mos e përsërisin më të njëjtin gabim. Marrim një shembull të një zgjedhësi nga jashtë, i cili në dijeninë e tij ka ngarkuar një dokument, i cili e përmban adresën. Ndërkohë për çfarëdolloj arsye është e pamundur të regjistrohet nga PER. Atëherë, çfarë veprimi kryen Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në këtë rast? Besoj e kontaktoni, apo jo? Apo thjesht e refuzoni? Në rastin kur zgjedhësi e ngarkon dokumentin, por për arsye teknike është e pamundur të konstatohet nga KQZ-ja, çfarë ndodh me këtë zgjedhës?

Znj. J. Josifi: Si e ka ngarkuar dokumentin, kur është e pamundur të konstatohet?

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Z. M. Çakaj: Unë e kam parë vetë personalisht kur një zgjedhës nga Greqia e ka ngarkuar dokumentin, i cili ishte me kod dhe ishte e pamundur të deshifroje dhe të bëhej vizualisht i dukshëm.

Znj. J. Josifi: Lexohen edhe ato. Prandaj janë ata dy personat teknikë, që ju përmendët pak më parë. Ka të bëjë vetëm me formatin e dokumentit. Zgjedhësi nuk e ka fiks në formatin që ne e pranojmë në PER, por ne me një soft në sitem, e bëjmë të lexueshëm. Mund ta verifikoni...

Z. M. Çakaj: Në fakt, unë e verifikova, por nuk është kështu siç thoni ju. Ishte hera e dytë që shtetësja nga Greqia po aplikonte dhe ju refuzua dhe herën e dytë. Përgjigjja që erdhi nga Help Line ishte që, “është e pamundur”. Patjetër që këto janë arsye objektive. Në rastin konkret, çfarë bën KQZ për ta mundësuar, pasi zgjedhësi në zbatim të gjithë rrugës që duhet të ndjekë siç ju e keni vendosur dhe ngarkon dokumentin, por për pamundësi teknike, objektive, është i palexueshëm. Në momentin që i është refuzuar dy herë, çfarë duhet të bëjë KQZ në rastin konkret? A duhet ta kontaktojë KQZ dhe ta orientojë që të mos ngarkojë një dokument të koduar apo t’i bëjë foto dhe ta ngarkojë në formatin e kërkuar? Ky është qëllimi i të gjithë diskutit.

Znj. J. Josifi: Jemi munduar të bëjmë sa mundemi, por patjetër që mund ta adresojmë këtë gjë edhe kështu, në mënyrë aktive pa pushim, gjatë gjithë kohës nga mëngjesi e deri në darkë, duke telefonuar zgjedhësit që konstatojmë se kanë pasur vështirësi. Ndërkohë, menjëherë pas mbledhjes do të nxjerrim edhe statistikat me asistencën e dhënë në të katër format e saj.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Josifi. Fjala për zonjën Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Siç e dini, pritshmëritë në lidhje me zbatimin dhe implementimin e këtij procesi janë të mëdha, prandaj edhe kolegu Çakaj me të drejtë ngriti një mori të madhe pyetjesh, të cilat burojnë nga shqetësime dhe janë shumë. Për sa kohë që kemi shtetas shqiptarë, të cilëve për herë të parë iu dhamë mundësinë që të aplikojnë të drejtën e tyre kushtetuese, atëherë ne sot duhej të ishim fleksibël dhe ta kishin realizuar këtë proces si duhej dhe të gjithë të ishim entuziastë për ditën e votimit. Zonja Josifi, unë sot në meritë të kësaj të drejte kushtetuese kaq të rëndësishme, ju drejtoj një pyetje. A është sot i thjeshtë procesi?

Znj. J. Josifi: Procesi sot është 100% në përputhje me rregullat që rregullojnë këtë proces.

Z. M. Çakaj: Si mund t'i thjeshtojmë rregullat dhe ta bëjmë procesin edhe më të thjeshtë? Në Kodin Zgjedhor, me ndryshimet e fundit të datës 26 korrik, organi drejtues i vetëm i ngarkuar nga Kuvendi për propozimin e akteve dhe ndryshimeve është vetëm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Mendoj se secili nga ne të pestë do ta kishte ndërmarrë iniciativën për të propozuar ndryshime. Në rastin konkret, kjo përgjigja juaj lë shumë për të dëshiruar. Të kemi këtë proces, të dështojnë në tentativën e parë, të dytë apo të tretë, 37.1% të shtetasve që jetojnë jashtë Shqipërisë, të dështojnë të regjistrohen dhe ne ta marrim me kaq lehtësi...

Znj. I. Nano: Duhet ta saktësojmë përqindjen.

Z. M. Çakaj: Më fal, 38%.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Faleminderit për ndërhyrjen sa munde procesin e përgjigjes, por përgjigje nuk mora dhe unë e konsideroj përgjigjen e zonjës që procesi nuk është i thjeshtë dhe nuk është i lehtë. Pra, vijon të jetë i tillë jo i thjeshtë, jo i lehtë. Kjo e bën atë që në dukje, në letër ftohen të gjithë që të bëhen pjesë e këtij procesi dhe nga ana tjetër u vendosen barrierat dhe u shtohen pengesat dhe burokracia, u shtohen disa elementë të panevojshëm dhe të pashpjegueshëm. Kjo deri tani nuk është sheshuar, apo jo, besoj? Se ju nuk keni një përgjigje ndryshe nga e para?

Znj. J. Josifi: Unë nuk thashë që procesi është... se ju e perifrazuat përgjigjen time. Unë thashë që është në përputhje me rregullat.

Znj. H. Vukaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është ai që mori të gjithë kompetencën për të miratuar në mënyrë eksplicite të gjithë elementet teknike të pajisjes elektronike të regjistrimit. Dhe është po ai që mund ta zgjidhë këtë mekanizëm dhe ta bëjë më të lehtë. Përveç nesh që në çdo mbledhje ju kemi bërë të ditur që jemi proaktivë në qasjen tonë për të ndërhyrë sa herë që ju të keni nevojë në aktet që juve ju duken apo i interpretoni si pengesa. Pra, procesi ende nuk është i lehtë dhe kjo është thyerje e parimeve që ne kemi miratuar. Së dyti, pasi filtri i parë kalohet nga operatorët, a ka një filtër të dytë që garanton cilësinë e vendimmarrjes nga ana e operatorëve?

Znj. J. Josifi: Po, auditët teknikienë.

Znj. H. Vukaj: Auditët teknikienë janë filtër i dytë?

Znj. J. Josifi: Po, e kanë pjesë të detyrave të tyre.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Sapo konfondove një akt... Detyrat e auditit teknikien, që ende nuk ka hyrë në lojë, prandaj dhe ju bëtë propozimin sot?

Znj. J. Josifi: Auditit teknikien ka hyrë në lojë sa i takon detyrave dhe përgjegjësiive për të monitoruar veprimet që bën KQZ-ja.

Znj. H. Vukaj: E nderuar, auditit teknikien nuk ka rol vendimmarrës, nuk është pjesë e organit administrativ të KQZ-së. Në fund të ditës, ju si drejtoreshë a bëni ju një vlerësim sigurie pro dhe kundër për të gjithë vendimmarrjen? Miratim apo refuzim të të gjithë listës që prodhon trupa operationale në fund të turnit të saj? Si rregull ju duhet të kontrolloni të gjithë... Po, me nivele. Fillimisht një nivel para jush dhe më pas ju. A ka nivel sigurie administrativ dhe shprehje vullneti?

Znj. J. Josifi: Vendimi për shqyrtimin e kërkesave i takon secilit operator. Në asnjë nga rregullat e vendimit...

Znj. H. Vukaj: Nuk i di njohuritë tuaja në fushën juridike pasi jeni IT, por që të shprehesh me akt apo vendim, do të thotë që je e autorizuar si shprehëse vullneti. Ata bëjnë vetëm punën mekanike të vlerësimit paraprak të kërkesave. Pyetja është shumë e thjeshtë. A keni ju një filtër të sigurisë të pranimit ose jo të kërkesës së depozituar për t'u regjistruar. A keni një filtër zonja Josifi?

Znj. J. Josifi: Jo, dhe as nuk kam autorizim që ta bëj. Vlerësimi i dikujt, pavarësisht nivelit të hierarkisë, nuk ka si të jetë mbi apo nën vlerësimin e dikujt tjetër. Shqyrtimi bëhet nga operatorët.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Ju keni përgjegjësinë që të garantoni cilësinë e përzgjedhjes që ka bërë. Po sikur ai operatori të ketë gabuar?

Znj. J. Josifi: Domethënë, të gjitha miratimet dhe refuzimet të kalojnë me një njeri të vetëm në fund?

Znj. H. Vukaj: Absolutisht, duhet të kalojnë në hallkat e drejtorisë suaj dhe më pas tek ju.

Znj. J. Josifi: I gjithë stafi im është duke shqyrtuar kërkesa po ashtu si edhe stafi me kohë të përkohshme.

Znj. H. Vukaj: Nëse ju e keni ulur në nivel operatorësh, atëherë është çështje tjetër. Ka apo nuk ka deri më sot filtra shqyrtimi?

Z. M. Çakaj: A mund të bëj një konstatim të vogël? Në vendimin numër 10, Kreu IV, pika 1 parashikon, “KQZ vendos për kërkesën për regjistrim jo më vonë se pesë ditë nga data e depozitimit të saj në PER”. Kjo do të thotë që është KQZ, që ka autoritetin për të vendosur për atë dhe as auditi apo dikush tjetër. KQZ, në rastin konkret, këtë të drejtë e ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i cili e materializon në nivele dhe po në këtë mënyrë duhet të kthehet. E riformuluar ndyshe kjo kërkesa e koleges Vukaj do të ishte: a kanë nivel kontrolli veprimet e operatorit? Pasi në fund të ditës është KQZ përgjegjëse përballë zgjedhësit që ka paraqitur kërkesën për regjistrim në PER. A ka nivel kontrolli? Fillimisht operatori, më pas përgjegjësi, ju dhe në fund fare Komisioneri. Nëse nuk ka një sistem të tillë kontrolli, e shihni të nevojshme për ta përfshirë në protokollet e sigurisë.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Bëhet fjalë për një të drejtë kushtetuese dhe ky është detyrim administrativ. Shprehja e vullnetit është detyrim administrativ që të kalojë në nivel hierarkik, poshtë-lart. Nga operatori, te përgjegjësat e sektorit, te ju dhe më pas te Komisioneri. Nëse nuk e keni aplikuar deri tani, mendoj se duhet ta realizoni sa më parë, pasi cënon vendimmarrjen dhe të drejtën e tyre për të ankimuar një akt të rregullt. Një akt që ka të gjitha tiparet edhe tipologjinë e një akti administrativ. E cënon këtë të drejtë. Pra, kriset siguria juridike e shprehjes së vullnetit për atë person.

Z. M. Çakaj: Që t'ua heqim merakun, nuk mund të ndryshojë asgjë Komisioni Rregullator, pasi për sa kohë që në fund të vendimit numër 10, kemi autorizuar Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi, ka të gjithë të drejtën dhe tagrin vendimmarrës që ta shtresëzojë me nivele këtë proces vendimmarrjeje. Kështu që, mos e kërkoni te Komisioni Rregullator.

Znj. H. Vukaj: Sa për dijeninë tuaj, audituesit nuk kanë të drejtë që të kthejnë mbrapa. Ata konstatojnë në funksion të sigurisë. Verifikojnë dhe krijojnë një panoramë të përgjithshme se ku është situata dhe për këtë bëjnë një raport. Nuk kanë të drejtën e ndërhyrjes tek operatorët aty. Unë do vazhdoja me një pyetje tjetër. A keni ju Live Chat në dispozicion të të gjithë aplikantëve?

Znj. J. Josifi: Po.

Znj. H. Vukaj: Nuk rezultonte dje që të ishte Live Chat.

Znj. J. Josifi: Si nuk rezultonte, kur?

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Dje, nga vizita që bëmë tek operatorët dhe vëzhgimi i punës së tyre nuk pamë që ata të ndërmerrnin...

Znj. J. Josifi: Edhe një herë, operatorët që ju keni vizituar dje janë operatorë që shqyrtojnë kërkesa...

Znj. H. Vukaj: Në lidhje me kërkesat, aty në moment t'i komunikohet se çfarë i mungon dhe të informohet më mirë se si mundet që ta përdorë atë platformë dhe ta qartësojë në lidhje me elementin.

Z. M. Çakaj: Në kuadër të thjeshtësimit dhe të diskutimit të të gjithë problematikave si edhe të zgjidhjes nëse mund t'i japim. Tani kjo historia... Ne nuk e kemi të thjeshtë as me njëri-tjetrin. Zgjedhësi aplikon dhe këtë kërkesë e shqyrton operatori, atë që ne vizituam dje dhe që ju e keni punë të përditshme. Ndërkohë Help Desk është në zyrë tjetër. Tani, ky operatori që e pranon apo e refuzon kërkesën, se nuk mund ta lerë në pritje, tjetër problem ky se nuk mundet që kërkesa të rrijë në pritje. Ju ose e refuzoni, ose e miratoni. Kur operatori që shqyrton kërkesën, si operon, ia delegon shefit të grupit të punës? Do të duhet zgjedhësi që të komunikojë dhe të kërkojë sqarime se pse i është refuzuar. Normalisht, ndërveprimi duhet të jetë në kohë reale. Operatori që shqyrton kërkesën, zgjedhësit t'i paraqesë, mundësisht të ishte rindërtuar sistemi edhe nëse ka mundësi që edhe të riorganizohet sistemi PER, që zgjedhësi të komunikojë me operatorin dhe të kërkojë sqarime se pse i është refuzuar kërkesa. Duhet t'i numërohen 1, 2, 3, 4, ose në pamundësi të kësaj, të ngarkohet përgjegjësi i atij turni, apo në nivel drejtoreshe të sqarohet zgjedhësi. Pse duhet që të jetë në një zyrë tjetër Help Line, në një kohë që nuk dihet nëse e ka apo jo informacionin. E kemi numrin e telefonatave se sa ju kontaktojnë? E kemi si shifër?

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 24.01.2025*

Znj. I. Nano: Kur jemi te refuzimi, jepen edhe arsytet e refuzimit.

Z. M. Çakaj: Nuk është problemi te arsyeja e refuzimit. Nuk është zgjidhje të refuzosh. Zgjidhje është si ta mundësosh regjistrimin. Një person që shfaq vullnetin, mund të mos e ketë informacionin e duhur. Ne prandaj jemi si hallkë ndërmjetëse, që ta regjistrojmë. Për analogji, zgjedhësi që është brenda Shqipërisë në regjistrin e gjendjes civile është pasiv. Ai nuk bën asgjë. Thjesht mbush moshën 18 vjeç dhe është aty në listë. Për të votuar më pas duhet të ketë një dokument identifikimi të vlefshëm. Ndërkohë që zgjedhësit jashtë po ia bëjmë shumë të vështirë procesin e regjistrimit, imagjino pastaj votimin.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Por ndërkohë 41 mijë e ca zgjedhësve tashmë të miratuar, fakti që kemi 41 mijë e ca zgjedhës unikë, shtetas, jo kërkesa, të miratuar, do të thotë që një pjesë e mirë ia kanë dalë, apo jo? Mund të na e thoni meqenëse doli kjo kërkesa...

Znj. J. Josifi: Nuk e kemi ne qëllimin të refuzojmë, se ne këtë punë bëjmë çdo ditë nga mëngjesi deri në 2 të natës. Për ne situata ideale si administratë dhe si nëpunës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është të kemi me të parën një kërkesë të saktë dhe të miratuar, sepse ne e dimë që kërkesat e refuzuara janë shtesë pune për ne në të gjitha drejtimet. Sigurisht që ne duam që të gjithë ata që bëjnë kërkesë me herën e parë, menjëherë të miratohen. Nuk kemi qëllimin të refuzojmë dhe as të dështojmë.

Znj. H. Vukaj: Cila është dinamika juaj për të refuzuarit, zonja Josifi? A i keni informuar ata me imeil apo me mjetet e tjera të komunikimit, meqenëse *live chat*-i ishte *black out*, që duhet të aplikojnë sërish përveç atyre informimeve të përgjithshme? Individualisht ju i keni kontaktuar me imeil, sms ose *WhatsApp*?

Znj. J. Josifi: Ka dy rrugë se si kontaktohen dhe sqarohen për refuzimin: me sms, nëse kanë zgjedhur këtë formë, me imeil nëse kanë zgjedhur imeilin.

Znj. H. Vukaj: Ju u thoni që u refuzuat me imeil ose me *WhatsApp* dhe nuk i thoni shiko se para se t'ju refuzojmë ju keni edhe mundësinë që të korrigjoni këtë e këtë? Nuk ia jepni këtë mundësi?

Znj. J. Josifi: T'ia jap pa e konstatuar?

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2025*

Znj. H. Vukaj: Po ti e ke konstatuar një herë aty se çfarë i mungon. Është zëvendësimi i *live chat*-it.

Znj. J. Josifi: Ne gjatë 10 ditëve të regjistrimit, duke konstatuar problematika konkrete, e kemi personalizuar sa më shumë që kemi mundur arsyen e refuzimit, pra e kemi përshtatur me rastin konkret. Nëse në fillim arsyeja e refuzimit ishte më e përgjithshme, pra dokumenti i adresës nuk plotëson kushtet ose nuk gjenden të dhëna në të, ne kemi 7 arsye refuzimi sot, pra atij zgjedhësi që ka trajtuar anën e gabuar të dokumentit, i themi të lutem vër anën tjetër; atij që nuk e ka fare adresën, i themi të lutem ...

Znj. H. Vukaj: Në meritë të lehtësimit, unë po ju shtroj sërish këtë pyetje: para se t'i thoni refuzohesh në mënyrë definitive, sepse atij nuk i shteron e drejta deri ditën që përcakton Kodi, por përpara kësaj saj, pas një thënie "refuzohet", sepse e demoralizon atë...

Znj. J. Josifi: Nuk i themi më refuzohet, i themi që kërkesa është e pa plotë dhe ka nevojë për plotësim.

Znj. H. Vukaj: Nuk tentoni ju që t'i thoni, shiko, zotëri, kërkesa juaj është në shqyrtim e sipër, por juve ju mungon një dokument i duhur identifikimi apo ju mungon një dokument i saktë adrese apo më gjerë. Ju nuk e bëni këtë në lehtësi të procesit dhe procedurës?

Znj. J. Josifi: Nuk kemi si ta bëjmë këtë gjatë shqyrtimit, sepse kërkesa pasi dorëzohet...

Znj. H. Vukaj: Absolutisht që mund të bëhet ajo.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2025*

Znj. J. Josifi: Këtë bëjmë ne, e kthejmë te zgjedhësi të paplotë dhe zgjedhësi duhet të ringarkojë dokumentin e duhur.

Znj. H. Vukaj: Teknikisht kjo është e mundur nga ç’kemi marrë informacion nga teknicienët e fushës. Komisioneri i përshtatet platformës me aktet e veta. Ne nuk po përshtatim këtë?

Znj. I. Nano: Aktualisht në akt nuk e kemi këtë lloj komunikimi.

Znj. H. Vukaj: Akti ynë janë norma të përgjithshme, nuk është se janë norma të detajuara. Atëherë zonja Josifi këtu na ka, mund ta propozojë në çdo sekondë këtë pikë, sepse është lehtësuese.

Znj. I. Nano: Nëse përmbushet teknikisht kjo kërkesë e zonjës Vukaj...

Znj. H. Vukaj: Na e nxorët numrin e shtetasve si është pranuar kërkesa deri tani?

Znj. J. Josifi: Po, e nxora, sipas ekranit të mëparshëm, se tani kanë kaluar 9 minuta, ka ndryshuar pak. Është 20 mijë e 546. Ishte 24 mijë e diçka kur e lexuam.

Z. H. Vukaj: Nxirre edhe një herë të lutem planin e parë. Pra, do të thotë që 20 mijë shtetasve u është refuzuar, pavarësisht se 4000 deri në momentin që ju përlllogaritët ishte aplikimi për disa herë. 20 mijë shtetas është shumë. Në këtë kuadër, për hir të shqetësimit që tregon ky numër, më lind përsëri pyetja: Ju çfarë qëndrimi mbani në lidhje me dokumentin që provon adresën? Qëndrimin që mbani sot, sepse qëndrimin që mbanit para një jave ose në mbledhjen e fundit tonën ka qenë i ndryshëm nga ai i vendimeve nr.10 dhe nr.11. Pra, ju kishit një qasje tjetër. Çfarë qëndrimi mbani sot? Si e keni unifikuar në lidhje me pranimin

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2025*

e një dokumenti që tregon adresën. Është lehtësuar apo është rixhid siç ka qenë qasja juaj në fillim?

Znj. J. Josifi: Unë nuk ndaj me ju këtë vlerësim, që sigurisht është juaji, për një qëndrim të mëparshëm rixhid dhe tani më të lehtësuar ose ndoshta po aq rixhid. Kjo është çështje e vlerësimit të gjithsecilit.

Znj. H. Vukaj: E kam në funksion të kësaj të drejtë kushtetuese, nuk e kam në funksion të asgjëje tjetër, kështu që sot, më thjesht: cili është qëndrimi që mbani për dokumentin që provon adresën?

Znj. J. Josifi: Duhet një dokument që provon adresën dhe plotëson kushtet e vendimit tuaj nr. 11.

Znj. H. Vukaj: Faleminderit që na referove vendimin nr.11 dhe të jemi mirënjohës, sepse nuk e dinim që ishte në vendimin nr. 11, por ishte në vendimin 13 dhe ti sapo na e the.

Znj. J. Josifi: Nuk mund të jap opinione të përgjithshme për raste specifike.

Znj. H. Vukaj: Je drejtoresha, zonja Josifi, ke përgjegjësi për këtë proces, ke tre vjet që i dedikohesh këtij procesi.

Znj. J. Josifi: E di që e kam këtë përgjegjësi.

Znj. H. Vukaj: Pikërisht ke përgjegjësi shumë të madhe, përgjegjësinë e një morie të madhe shqiptarësh, me miliona.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2025*

Znj. J. Josifi: E di, e kemi të gjithë bashkë. E di këtë.

Znj. H. Vukaj: Së pari, ju se jeni në rol ekzekutiv, tonin e mbajmë ne mbi shpatulla dhe ndaj i shtrojmë këto pyetje.

Znj. J. Josifi: Dakord.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Kalojmë te zoti Nuri.

Z. F. Nuri: Përshëndetje dhe faleminderit edhe një herë për mundësinë! Ne si Parti Demokratike kemi shqetësimin që u tha dhe u përsërit gjatë kësaj mbledhje në lidhje me mundësinë e ndërveprimit të KQZ-së me zgjedhësit, sepse kërkojmë që të këtë një lehtësi të procesit. Shohim nga këto shifra, ne po bazohemi mbi shifrat përpara shpjegimit, në kuptimin që të gjithë e dini që janë shifra për herë të parë, tani gjatë mbledhjes doli që janë shifra që mund të këtë edhe aplikime që janë bërë disa herë, nga ai total ka rreth 37% të aplikimeve, po i marrim në tërësi që janë refuzuar. 37% është një shifër jashtëzakonisht e lartë, u tha edhe në këtë mbledhje dhe dua ta nënvizoj, ta ripërsëris që kjo tregon që procesi nuk është i thjeshtë, nuk është i lehtë. Secili nga ne ka shembuj konkretë nga personat që mund t'i kenë kontaktuar dhe mund të kenë pasur shumë shqetësime në lidhje me këtë proces. Unë do të doja të shihej mundësia nga KQZ-ja, nga Rregullatori që procesi të lehtësohet e të jetë më transparent, më gjithëpërfshirës dhe të kishte një ndërveprim më aktiv nga ana e KQZ-së. Në çfarë kuptimi? Sepse po shohim një numër shumë të lartë të refuzimeve në përqindje dhe për më tepër te kategoria e grave dhe e vajzave, pra diferenca ndërmjet aplikantëve meshkuj e femra është ngushtuar, shohim që ka një diferencë shumë të madhe, pothuajse dyfishi i meshkujve në krahasim me aplikimet e vajzave dhe grave. Kështu që edhe aty ka nevojë për sqarime, për lehtësi në komunikim e në proces, në mënyrë që të shtohet

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2025*

numri i aplikimeve. Nga ana tjetër, kemi edhe për rastin e Italisë, që ka qenë në rast problematik...

Znj. I. Nano: Jemi shoqëri maskiliste, zoti Nuri.

Z. F. Nuri: Të mundohemi ta ndryshojmë sadopak. Këto përqindje e tregojnë. Por ajo që desha të shpreh edhe një herë është se ka probleme në lidhje me aplikimin e personave, po marrim rastin konkret të Italisë, ku pikërisht janë zonjat që e kanë më të vështirë ndoshta që të vërtetojnë adresën e saktë ku banojnë prej vitesh. Duhet të ketë një sqarim të ngarkojnë, të hedhin në sistem disa dokumente, jo vetëm një. Ose të lihet mundësia në sistem që të ketë vende të posaçme ku mund të hidhen disa dokumente, jo në një vend bashkë, që do të kërkonte nevojën e bashkimit të tyre në PDF apo materiale të tjera, që është pak teknike dhe shumë pak persona dinë t'i përdorin të gjitha këto aplikacione. Çfarë kemi vënë re ne tjetër që është shqetësuese? Duhet ta them patjetër, ka shtetas shqiptarë që jetojnë në diasporë, që janë në një moshë të caktuar, por janë edhe me arsim të lartë dhe nuk kanë arritur ta bëjnë dot aplikimin me sukses herën e parë. Dhe kjo është shqetësuese, sepse tregon shkallën e vështirësisë relativisht të lartë të këtij procesi. Kur nuk arrijmë dot ta bëjmë herën e parë aplikimin në mënyrë të saktë shtetas që janë me arsim të lartë, imagjinoni se çfarë ndodh me shtetas të tjera të popullsisë në diasporë apo kudo qofshin ata, sepse ka mundësi ta bësh aplikimin nga Shqipëria për ata që ndodhen sot në Shqipëri dhe mund të shkojnë të rikthehen në vendet e tyre ku kanë banimin e përhershëm. Përfundimisht do të kërkoja që të ketë një vëmendje të shtuar nga ana e KQZ-së në lidhje me këto problematika. Ndërsa për sa u përket debateve që dolën në këtë mbledhje, sa i takon ndarjes së përqindjeve apo aplikimeve të ndryshme, unë kam një propozim për administratën e KQZ-së. Mendoj që mund ta ndajmë edhe me përfaqësues të tjerë ose me ju të njëjtin mendim dhe të njëjtin shqetësim. Nëse rezulton që

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2025*

aplikimet, janë rreth 66 mijë aplikime aktualisht, nëse aty brenda ka aplikime që janë kryer nga persona disa herë, pra i njëjti person, i njëjti qytetar ka aplikuar disa herë, ne do të donim të kishte një listë, për efekt edhe transparence, ose numri i personave që kanë aplikuar për herë të parë që janë unikë. Sa persona unikë kanë aplikuar? Këtë do të donim që ta kishim dhe mundësisht të kishim të dhëna me përqindje se sa persona kanë aplikuar nga dy herë, sa nga tre herë, sa nga katër e me radhë ose më shumë se tre herë, po themi, që të kemi edhe ne të dhëna më të sakta dhe t'i adresojmë më vonë nëse lind nevoja në këtë mënyrë. Kjo është pak a shumë si klikimet në *youtube*, t'i ndajmë cilat janë aplikimet unike nga ato që janë aplikime të dublikuara ose që disa herë i njëjti person aplikon, që tenton të regjistrohet. Sa u takon numrave unikë që janë të miratuar, kemi shifrën 41 mijë e 500, por është logjike një herë do të miratohet aplikimi i dikujt, nuk mund të miratohet dy herë. Kështu që kërkoj të kemi këto të dhëna dhe këto statistika në këtë format brenda mundësive teknike të KQZ-së. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Zoti Nuri, faleminderit! E ka kërkuar fjalën zonjë Xhina.

Znj. E. Xhina: Faleminderit! Në vijim të diskutimeve, e kuptojmë që thelbi i të gjithë procesit në fakt, për mendimin tim, qëndron në ndërveprimin e operatorëve me personat që aplikojnë për t'u regjistruar. Ditë më parë ne bëmë edhe një diskutim si parti politike në lidhje me përgjigjen që operatori i kthente në refuzim qytetarit dhe kërkuam që të kishte një riformatim të përgjigjes. Kemi qenë te kjo sallë kur kemi bërë një mbledhje me Komisionerin Shtetëror kur u miratua akti "Për miratimin e rregullores për shqyrtimin e kërkesave" dhe, në fakt, jo vetëm unë, por edhe kolegu Nuri kemi këmbëngulur që përgjigja që i kthehej qytetarit për refuzim të mos ishte e thatë, por të ishte e plotë. Por, në fakt, pamë që përgjigja fillimisht ishte refuzuar dhe me një arsye shumë të përgjithshme, më pas arsyet erdhën duke u specifikuar edhe më mirë nga operatorët, por sërish ne

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2025*

kërkuam që përgjigjet të ishin konkrete, pra refuzimet e tyre. Përgjigjet e refuzimit të përmbanin shkakun e refuzimit qartësisht. Nuk e di nëse është bërë e mundur tashmë që të kemi një riformatim të përgjigjes së refuzimit të qytetarëve, si dhe të mos jetë fjala “refuzuar”, pasi do ta dekurajonte qytetarin që aplikon. Ne kërkuam të kishte një formatim tjetër të kërkesës dhe nuk e di nëse është e mundur të kemi një evidentim, qytetarët që kanë riaplikuar, a kanë qenë të saktë në riaplikimet e tyre, sepse do të kuptojmë sa qartësisht ka qenë edhe përgjigja e refuzimit, të kemi një shifër sa nga këta që kanë riaplikuar u janë pranuar kërkesat dhe të mund të evidentohen të gjitha rastet që kanë aplikuar disa herë dhe që janë refuzuar për t’u kontaktuar siç u tha edhe më parë nga ana juaj dhe jam shumë dakord me këtë. Pra, duhet një politikë më afër nga operatorët që shqyrtojnë kërkesat me qytetarët që janë refuzuar disa herë. Unë nuk e mohoj që është bërë një punë shumë e madhe nga i gjithë stafi, sepse është e thjeshtë që ne të bëjmë këtu retorikë në diskutime, sepse është ngarkesë shumë e madhe, por që akoma duhet t’i japim më shumë impuls që kontakti midis operatorëve dhe qytetarit të jetë më i afërt për t’u shtyrë dhe për të qartësuar shenjat e refuzimit. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit, zonja Xhina! Zonja Vukaj, po.

Z. H. Vukaj: Sapo mora dijeni që në zyrën tonë të protokollit është administruar një kërkesë drejtuar zotit Ilirjan Celibashi, Komisionerit, me nr. 423 Prot., 23.1.2025, prej audituesve dhe në një nga pikat thuhet: “Në zbatim të vendimit të përbashkët të Komisionerit për caktimin e detyrave dhe përgjegjësive të audituesve teknikienë për mbikëqyrjen e veprimeve të realizuara nga KQZ-ja për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë, në një nga pikat kërkohet mënyra aktuale e realizimit të njohjes së personit me fotot e ngarkuara në sistem, ku përfshihet edhe fotoja e marrë nga indentitec dhe mënyra e vendimmarrjes për miratimin ose refuzimin e aplikantit nëse ekziston një nivel mbikëqyrës që

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2025*

certifikon vendimet e operatorëve.”. Kjo është për dijeninë tuaj që e kanë kërkuar si informacion edhe audituesit për veprimtarinë që ushtrojnë operatorët. Në mbyllje të kësaj, për sa më përket mua personalisht, do t’u bëja thirrje të gjithë shtetasve shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të mos heqin dorë kurrë deri ditën e fundit nga tentativa për t’u regjistruar. Regjistrohuni, regjistrohuni, regjistrohuni, regjistrohuni, sepse është e drejta juaj sublimë, kushtetuese, e cila ju përket në mënyrë absolute ta ushtroni ju të pandikuar dhe me lirshmërinë më të madhe. Kështu që ne ndaj jemi këtu për të bërë gjithë këtë demarsh që kjo e drejtë të bëhet e realizueshme.

Znj. I. Nano: Faleminderit, zonja Vukaj! Besoj bashkohemi të gjithë me thirrjen për t’u regjistruar sa më shumë shtetas shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në mënyrë që të votojnë në zgjedhjet e 11 majit. Çështje të tjera jashtë rendit të ditës nuk kemi. Para se të mbylлим mbledhjen, një kujtesë për Drejtorinë e Ligjshmërisë për zbardhjen e ndryshimeve në akt, në mënyrë që sot të nënshkruhen, sepse do të duhet të dërgohet vendimi DPGJC-së. Zonja Josifi, gjatë mbledhjes u drejtuan disa pyetje qoftë nga anëtarët, qoftë nga përfaqësuesit e partive politike, në mundësinë tuaj më të parë mund t’i adresoni me imeil sipas kërkesës. Mbledhjen e deklarojmë të mbyllur. Ditë të mbarë!